



Funded by  
the European Union

## Sfida 50/50:

Zbatimi i kuotës gjinore në bordet e institucioneve publike



Qershor 2021

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 

## Sfida 50/50:

Zbatimi i kuotës gjinore në  
bordet e institucioneve publike

Qershor 2021

### Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

### Përmbajtja

#### 4 Hyrje

4 Obligimi ligjor për përfaqësim të barabartë gjinor

5 Dominimi i burrave në ndërmarrje publike dhe agjenci të pavarura

10 Përfundimet



Funded by  
the European Union

KOSOVO 2.0

gap INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE

## Shkurtesat

<b>AD</b>	Akademia e Drejtësisë
<b>AKK</b>	Agjencia Kundër Korrupsionit
<b>AKKVP</b>	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
<b>AMKMK</b>	Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
<b>ANJF</b>	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
<b>ARKEP</b>	Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike – Postare
<b>ARRH</b>	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
<b>ARRU</b>	Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit
<b>ASHMDHP</b>	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Kosovës
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>KOSTT</b>	Operatori i Sistemit të Transmisionit
<b>KPM</b>	Komisioni i Pavarur i Mediave
<b>KPMM</b>	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
<b>KRPP</b>	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
<b>KRM "Ambienti"</b>	Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ambienti” Sh.A. Pejë
<b>KRU "Bifurkacioni"</b>	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit “Bifurkacioni” Sh.A. Ferizaj
<b>KRU "Gjakova"</b>	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Gjakova” Sh.A. Gjakovë
<b>KRU "Hidro." Pejë</b>	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini” Sh.A. Pejë
<b>KRU "Hidro." Prizren</b>	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren
<b>NPB</b>	Ndërmarrja Publike Banesore
<b>Ngrohtorja Gjakovë</b>	Ngrohtorja e Qytetit Sh.A. Gjakova
<b>OSHP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>PK</b>	Posta e Kosovës
<b>TRUST</b>	Fondi i Kursimeve Pensionale
<b>TU</b>	Trafiku Urban
<b>ZRRE</b>	Zyra e Rregullatorit për Energji
<b>IHK</b>	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës

## Hyrje

Në mbledhjen e nëntë më 26 prill 2021, Qeveria e Kosovës ka anuluar vendimin e qeverisë paraprake për emërimin e anëtarëve të bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikimet Elektronike (ARKEP).<sup>1</sup> Qeveria e arsyetoi vendimin e saj duke thënë se propozimi i Qeverisë Hoti ishte në shkelje të kuotës gjinore prej 50% të përcaktuar në Ligjin për barazinë gjinore.

Ligji për barazi gjinore i cili është në fuqi që nga viti 2015 kërkon përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera. Por deri më tani institucionet publike kanë injoruar obligimin ligjor për përfaqësim të barabartë, duke interpretuar dispozitat e Ligjit për barazi gjinore si jo obligative. Madje, për këtë ekziston edhe një vendim gjyqësor. Në vitin 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit parashtrroi padi ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pasi që KQZ nuk kishte respektuar Ligjin për barazi gjinore me rastin e certifikimit të listave të kandidatëve të partive politike për deputetë.<sup>2</sup> Por, padia e Avokatit të Popullit u hodh poshtë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar dëshmi se kush është diskriminuar dhe nuk janë përfshirë në listat zgjedhore.<sup>3</sup>

Megjithatë, vendimi i Qeverisë për bordin e ARKEP vendos një precedent se si mund të vazhdojë të veprojë qeveria e tanishme gjatë mandatit të saj sa i përket emërimeve të anëtarëve të bordeve. Duke pasur parasysh që bordet e institucioneve publike në Kosovë kanë mbipërfaqësim të burrave,<sup>4</sup> atëherë mund të presim që gjatë mandatit të kësaj qeverie të ketë ristrukturime të tilla edhe në borde tjera.

Në këtë analizë, Instituti GAP do të shikojë bazën ligjore për përfaqësim të barabartë gjinor në bordet publike dhe do të paraqesë një mostër të përbërjes aktuale të bordeve të agjencive të pavarura dhe ndërmarrjeve publike. Duke llogaritur pozitën që do të jenë të lira në vitet e ardhshme dhe duke marrë parasysh precedentin qeveritar të përfaqësimit të barabartë gjinor, GAP do të paraqesë numrin e vendeve të rezervuara për gratë në bordet e institucioneve publike gjatë këtij mandati qeveritar.

## Obligimi ligjor për përfaqësim të barabartë gjinor

Në Kosovë ekzistojnë ligje dhe rregullore të ndryshme të cilat zyrtarisht mbrojnë dhe promovojnë trajtim të barabartë të grave dhe burrave në politikë, arsimim, shëndetësi, ekonomi, dhe veçanërisht në punësim, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Me qëllim të parandalimit të diskriminimit gjinor në këto sfera, Ligji për barazi gjinore detyron analizimin e statusit të grave dhe burrave dhe promovimin e planeve dhe politikave që kanë për synim përfaqësimin e barabartë të tyre.<sup>5</sup> Kur bëhet fjalë për përfshirjen e grave dhe burrave në sferën publike, e në veçanti në institucione publike, sipas nenit 6, paragrafit 8 të këtij ligji, “përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.”<sup>6</sup>

1 Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3zivTdd>

2 Institucioni i Avokatit të Popullit. Deklaratë e Avokatit të Popullit lidhur me përfaqësimin e barabartë gjinor në procesin për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2019. 5 shtator 2019. Burimi: <https://bit.ly/3gyitCr>

3 Aktvendimi C.nr.3258/19, 1 teor 2019. Burimi: <https://bit.ly/3q434Nb>

4 Instituti GAP - Ndërmarrjet Publike Legjislacioni dhe Bashkëpunimi me Institucionet Zyrtare.

Burimi: <https://bit.ly/3v4zsQC>. Shih edhe: Grupi për Ballkan - Gratë në politikë III – Përfaqësimi Gjinor në Nivel Lokal. Burimi: <https://bit.ly/3gl5C5d>

5 Ligji për barazi gjinore. Burimi: <https://bit.ly/3pCV9WX>

6 Ibid., neni 16

Megjithatë, përkundër obligimeve ligjore, institucionet publike në Kosovë si agjencitë e pavarura dhe Ndërmarrjet Publike (NP) kanë mbipërfaqësim të burrave, si në pozita ekzekutive (anëtarësi në borde apo kryesi të atyre institucioneve), ashtu edhe në pozita menaxheriale. Sipas një studimi të më hershëm të Institutit GAP, gratë janë të nënpërfaqësuar në institucionet publike në Kosovë dhe institucionet menaxhohen kryesisht nga burrat. Në bazë të të dhënave të studimit, gratë përbëjnë vetëm rreth 15% të anëtarësisë në borde në institucione publike, kurse vetëm 10% e bordeve udhëhiqen nga gratë.<sup>7</sup> Për më tepër, kjo natyrë e shpërndarjes të burrave dhe grave në institucioneve publike qëndron edhe tani.

Emërimi i anëtarëve të bordeve të këtyre institucioneve publike rregullohet përmes ligjeve të caktuara. Ligji për ndërmarrjet publike rregullon çështjen e pronësisë dhe qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike qendrore dhe atyre lokale. NP-të lokale janë në pronësi të komunës ose të komunave si aksionarë të ndërmarrjes. Ndërsa, ndërmarrjet qendrore janë në pronësi të Republikës së Kosovës ku qeveria gëzon të drejta ekskluzive sa i përket menaxhimit dhe ushtrimit të së drejtës së aksionarit. Sa i përket qeverisjes korporative, aksionarët ushtrojnë të drejtën e emërimit të anëtarëve të bordit të drejtorëve të NP-ve.

Bordet e drejtorëve në ndërmarrje publike qendrore përbëhen nga pesë deri në shtatë anëtarë ndërsa në NP lokale pesë anëtarë. Këto borde, ndër tjerash, ushtrojnë të drejtën e mbikëqyrjes së vazhdueshme të punës së zyrtarëve të NP-së dhe të aprovimit të planit të biznesit i cili përcakton synimet e ndërmarrjes për një vit financiar. Si rezultat, fuqia vendimmarrëse e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike është tejet e lartë.

Në maj të vitit 2015, pas plotësim-ndryshimit të Ligjit për ndërmarrje publike, verzionit paraprak iu shtua një paragraf i rëndësishëm lidhur me përbërjen e bordeve të drejtorëve të NP-ve. Neni 6 obligoi aksionarët e ndërmarrjeve publike të emërojnë anëtarë të bordeve të NP-ve në harmoni me Ligjin për barazi gjinore.<sup>8</sup> Ky paragraf sqaroi se kuota gjinore plotësohet atëherë kur arrihet përfaqësim prej 50% për secilën gjini. Qëllimi i këtij ndryshimi ka të bëjë me rritjen e përfaqësimit dhe avancimit të barazisë gjinore në vendimmarrjen e ndërmarrjeve publike.

## Dominimi i burrave në ndërmarrje publike dhe agjenci të pavarura

Përbërja aktuale e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura është e dominuar nga burrat. Në pothuajse çdo pozitë udhëheqëse, gratë janë të nënpërfaqësuar. Tabela 1 paraqet pjesëmarrjen e gjinive në bordet e shumicës së ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura.

Te agjencitë e pavarura, mesatarisht 28 përqind e pjesëmarrjes në borde janë gra ndërsa në ndërmarrjet publike 27 përqind. Gjashtë nga dymbëdhjetë agjencitë e paraqitura më poshtë nuk kanë në përbërje të bordeve të tyre asnjë grua. Ky hendek gjinor është prezent edhe te NP-të qendrore dhe lokale ku pesë nga 14 ndërmarrje kanë në përbërje të bordeve vetëm burra.

Dallimi është edhe më i thellë në pozitën e Kryeshefit/es Ekzekutiv/e (KE) ku nga 32 institucionet publike vetëm dy udhëhiqen nga gratë. Ndërsa, sa i përket pozitave të tjera menaxheriale, gratë janë më mirë të përfaqësuar krahasuar me bordet e drejtorëve, mirëpo, përsëri larg përfaqësimit të barabartë siç është përcaktuar me Ligjin për barazi gjinore.

7 Instituti GAP. Ndërmarrjet Publike - Legjislacioni dhe Bashkëpunimi me Institucionet Zyrtare. Burimi: <https://bit.ly/3v4zsQC>

8 Ligji Nr. 05/L -009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar më Ligjin Nr. 04/L-111. Burimi: <https://bit.ly/2TAzIde>

**Tabela 1.** Përfaqësimi gjinor në pozita udhëheqëse të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura

Institucioni	Bordi i drejtorëve			Pozita menaxheriale			
	Gra	Burra	Përfaqësimi i grave %	Kryeshefi Ekzekutiv	Gra	Burra	Përfaqësimi i grave %
<b>1. Agjencitë e pavarura</b>	<b>16</b>	<b>42</b>	<b>28%</b>	<b>B</b>	<b>59</b>	<b>131</b>	<b>31%</b>
1.1 AD	3	6	33%	B	3	2	60%
1.2 AKKVP	3	-	100%	B	6	11	35%
1.3 ARKEP	2	3	40%	B	1	6	14%
1.4 ARRH	0	4	0%	B	2	5	29%
1.5 KOSTT	2	4	33%	B	3	13	19%
1.6 KPM	2	4	33%	B	4	5	44%
1.7 KPMM	0	5	0%	B	1	9	10%
1.8 TRUST	0	6	0%	B	0	6	0%
1.9 ZRRE	0	2	0%	B	1	5	17%
1.10 OSHP	-	-	-	-	2	3	40%
1.11 AMKMK	-	-	-	-	3	4	43%
1.12 AKK	-	-	-	-	7	9	44%
1.13 KGJK	-	-	-	-	4	8	33%
1.14 ARRU	-	-	-	B	1	4	20%
1.15 BQK	0	2	0%	B	19	34	36%
1.16 KRPP	0	3	0%	-	-	-	-
1.17 ASHMDHP	-	-	-	B	1	5	17%
1.18 ANJF	4	3	57%	G	1	2	33%
<b>2. Ndërmarrjet publike</b>	<b>16</b>	<b>44</b>	<b>27%</b>	<b>-</b>	<b>28</b>	<b>42</b>	<b>40%</b>
2.1 IHK "INFRAKOS"	2	2	50%	B	-	-	-
2.2 KEK	2	2	50%	-	-	-	-
2.3 KRM "Ambienti"	0	4	0%	B	1	2	33%
2.4 KRU Bifurkacioni	2	2	50%	B	2	7	22%
2.5 KRU Gjakova	0	4	0%	G	10	10	50%
2.6 KRU Hidro. Peje	0	6	0%	B	2	1	67%
2.7 KRU Hidro. Prizren	1	3	25%	B	1	6	14%
2.8 KRU Hidro. Gjilan	2	4	33%	B	2	2	50%
2.9 Ngrohtorja Gjakove	0	4	0%	B	3	0	100%
2.10 PK	2	2	50%	B	-	-	-
2.11 "Trepça" Sh.A.	0	5	0%	B	-	-	-
2.12 TU	1	2	33%	B	1	2	33%
2.13 KRM "Çabрати"	2	2	50%	B	2	7	22%
2.14 NPB	2	2	50%	B	4	5	44%
<b>Totali</b>	<b>32</b>	<b>86</b>	<b>27%</b>	<b>8%</b>	<b>87</b>	<b>173</b>	<b>33%</b>

Burimi: Instituti GAP<sup>9</sup>

<sup>9</sup> Instituti GAP, bazuar në përgjigjet e institucioneve në bazë të kërkesës me datë 21 Maj, 2021. Të dhënat e përbërjes së bordeve dhe pozitave udhëheqëse të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura janë pranuar përmes formës elektronike nga 18 agjenci të pavarura dhe 14 ndërmarrje publike.

Përfaqësimi i barabartë gjinor jo vetëm që është detyrim ligjor dhe e drejtë në vetvete, por edhe është dëshmuar se përmirëson vendimmarrjen. Shumë studime vlerësojnë se gratë në përgjithësi janë më të shkolluara, të përgjegjshme dhe më pak të korruptueshme se burrat.<sup>10</sup> Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH) vlerëson se avancimi i barazisë gjinore në borde të ndërmarrjeve përmirëson vendimmarrjen.<sup>11</sup> Sipas OBEZH, shtetet duhet të synojnë vendosjen e kuotave dhe targeteve gjinore për të arritur përfaqësim më të barabartë gjinor në nivele të bordeve dhe në vendimmarrje në përgjithësi.<sup>12</sup>

Mirëpo, me përbërjen aktuale të ndërmarrjeve, duhet një kohë për të arritur një pjesëmarrje më të balancuar gjinore. Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, anëtarët e zgjedhur të bordit ushtrojnë mandat prej tri viteve. Megjithatë, aksionari/ët si qeveria apo komuna/t rezervojnë të drejtën e shkarkimit dhe zëvendësimit të anëtarëve të bordit në rast të shkeljeve ligjore. Përveç kësaj, pas përfundimit të mandatit të anëtarëve të zgjedhur, qeveria dhe komunat e kanë mundësinë e ristrukturimit të bordeve dhe agjencive të pavarura në mënyrë që të arrijnë një përfaqësim gjinor të barabartë në borde në përputhje me Ligjin për barazi gjinore. Grafiku 1 paraqet numrin e anëtarëve të bordeve të NP-ve dhe agjencioneve të pavarura nëpër muaj kur pritet të ju skadojë mandati. Si përfundim del se deri në fund të vitit 2021 41 anëtarë të bordeve mund të zëvendësohen ku në rast se respektohet Ligji për NP dhe Ligji për barazi gjinore atëherë është e mundshme të përmirësohet bilanci gjinor aktual nëpër borde publike.

10 Barazia gjinore në pozicionet vendimmarrëse: përfitimet e efikasitetit. Autore: Paola Profeta.


Burimi: <https://bit.ly/3g8kovP>

11 Parimet e Qeverisjes së Korporatave. Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Burimi: <https://bit.ly/3chosyh>

12 Ibid.

**Grafiku 1.** Numri i anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura sipas datës së skadimit të mandatit



Burimi: Instituti GAP<sup>13</sup>

<sup>13</sup> Instituti GAP, bazuar në përgjigjet e institucioneve në bazë të kërkesës me datë 21 Maj, 2021. Të dhënat e përbërjes së bordeve dhe pozitave udhëheqëse të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura janë siguruar përmes formës elektronike nga 20 agjenci të pavarura dhe 13 ndërmarrje publike.



## Përfundimet

Në mbledhjen e nëntë të qeverisë së Kosovës për herë të parë u anulua një vendim për emërimin e anëtarëve të ri të bordit me arsyetimin se nuk ishte respektuar Ligji për barazi gjinore. Mirëpo marrë parasysh se Ligji për ndërmarrje publike parasheh numër tek të anëtarëve të një bordi në ndërmarrje publike dhe në të njëjtën kohë obligon respektimin e përfaqësimit të barabartë (50%) gjinor, e bënë arritjen e këtyre dy qëllimeve matematikisht të pamundur. Megjithatë, përfaqësimi gjinor prej 50 përqind mund të arrihet në të gjitha përbërjet e ndërmarrjeve publike në mesatare, ku në disa kompani apo institucione një anëtar më shumë do të ishte burrë ndërsa në disa të tjera një grua. Kështu do të mund të arrihej përfaqësim i barabartë gjinor ku pozitat udhëheqëse janë numër tek.

Aktualisht ekziston një hendek i thellë i përfaqësimit gjinor në borde dhe pozita menaxheriale të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura. Në shumicën e ndërmarrjeve publike, mesatarisht 27% e përbërjes së bordeve janë gra ndërsa 28% në agjencitë e pavarura. Në pesë nga 14 ndërmarrjet publike, gratë nuk janë fare të përfaqësuara. Në pozita menaxheriale të NP-ve dhe agjencive të pavarura vetëm 33% janë gra ndërsa vetëm dy kanë kryeshefe ekzekutive nga 32 institucionet e analizuar.

Ligji aktual i ndërmarrjeve publike ofron mandat prej tri viteve për çdo anëtar të zgjedhur të bordit. Megjithatë, shkeljet ligjore mundësojnë qeverisë dhe komonave të shkarkojnë bordin dhe të ristrukturojnë ato në përputhje me Ligjin për barazi gjinore. Po ashtu, deri në fund të vitit 2021, mbi 50 mandate të bordeve të NP-ve dhe agjenci të pavarura përfundojnë. Kjo mundëson qeverinë dhe komunat të përmirësojnë dhe avancojnë përfaqësimin e barabartë gjinor në vendimmarrje. Përfaqësimi i barabartë gjinor është e drejtë ligjore dhe sipas OBEZH-it përmirëson performancën e ndërmarrjes. Prandaj, vendimi i qeverisë për anulimin e propozimit të anëtarëve të bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikimet Elektronike nga qeveria e kaluar duhet të vendosë një rregull të ri në respektimin e Ligjit për barazi gjinore.


Për më tepër, duke marr parasysh se institucionet nuk publikojnë të dhëna të sakta për përbërjen gjinore në borde dhe në ekzekutiv, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) duhet të publikojë të dhënat e sakta të përbërjeve të ndërmarrjeve publike dhe pozitave menaxheriale sipas gjinisë dhe nëse janë respektuar aktet ligjore në emërimin e anëtarëve të bordeve të NP-ve.



Funded by  
the European Union

Projekti “Inovacioni për mediat e  
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar”  
i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 

  
KOSOVO 2.0



Funded by  
the European Union

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 

**Sfida 50/50:**  
Zbatimi i kuotës gjinore në  
bordet e institucioneve publike